

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

01.12.2022
Ora, 11:11

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për dhënien e mandatit të Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, Qarku Tiranë, zotit Petrit Dine Doda”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. E. Allushi.**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa)**
- **Të tjerë:** **Përfaqësues nga KRIIK, PAK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita, atëherë sot në seancën publike kemi në rend të ditës për shqyrtim këto projektvendime:

Projektvendim “Për dhënien e mandatit të Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, Qarku Tiranë, zotit Petrit Dine Doda”.

Projektvendim “Për dhënien e mandatit të Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, Qarku Tiranë”. Respektivisht për zotin Petrit Doda dhe zonjën Orjela Nebijaj.

Pika e tretë është projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Gramsh”.

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë”.

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Skrapar”.

Projektvendim “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Projektvendim “Për edukimin, informimin, ndërgjegjësimin, si dhe për krijimin e kushteve lehtësuese për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi ndryshe”.

Projektvendim “Për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë për zgjedhjet”.

Projektvendim “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të disa materialeve zgjedhore që përdoren nga administrata zgjedhore”.

Projektvendim “Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Projektvendim “Për miratimin e programit për trajnimin dhe monitorimin e administratës zgjedhore dhe të disa aktorëve të tjerë për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore”.

Projektudhëzim “Për mënyrën e komunikimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me bashkitë në kuadër të bashkërendimit të informacionit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Gjithashtu kemi dhe një çështje të mbartur nga seanca publike e shkuar:

Projektvendimi “Për miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.

Kemi një çështje që duam ta fusim në rendin e ditës që ka të bëjë me plotësimin e një vakance...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

Z. Y. Merkaj: Të Këshillit të Bashkisë Devoll.

Z. I. Celibashi: Atëhere, shtohet në rendin e ditës edhe projektvendimi që ka të bëjë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Devoll. Paraprakisht në lidhje me: Projektvendimin “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Projektvendimin “Për edukimin, informimin, ndërgjegjësimin, si dhe për krijimin e kushteve lehtësuese për pjesëmarrjen në zgjedhje të personave me aftësi ndryshe”.

Projektvendimin “Për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë për zgjedhjet”.


Projektvendimin “Për miratimin e modelit dhe specifikimeve të disa materialeve zgjedhore që përdoren nga administrata zgjedhore”, si dhe:

Projektudhëzimi “Për mënyrën e komunikimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me bashkitë në kuadër të bashkërendimit të informacionit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Gjithashtu dhe pika e rendit të ditës e mbartur nga seanca e mëparëshme publike. Të gjitha këto që listova së fundmi, do të shtyhen për një seancë tjetër, për shkak se vetëm dje ne si KQZ, kemi marrë mendime dhe opinione nga organizata të shoqërisë civile thuajse për të gjitha këto projektvendime, por dhe nga parti politike. Në kuadër të konsiderimit dhe vlerësimit nga ana jonë gjë që kërkon kohë, mendoj për t’i shtyrë për një ditë tjetër, seancën do ta njoftojmë sot, por në parim ndoshta e mërkura e javës tjetër mund të jetë. Ndërkohë stafi të shohë për të reflektuar të gjitha ato mendime dhe opinione që kanë prezantuar organizata të ndryshme të shoqërisë civile për të gjitha këto projektakte.

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

Atëhere, vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me dhënien e mandatit të Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, Qarku Tiranë, zotit Petrit Dine Doda. Po, sekretari për të relatuar projektaktin!

Z. Y. Merkaç: Kuvendi i Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës. Vakancë kjo e krijuar nga dorëheqja e deputetit Alfred Rushaj, i zgjedhur në zonën zgjedhore të Qrkut Tiranë, propozuar nga Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim. Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve datë 2.03.2021, nr.107. Gjithashtu Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 409, datë 23.06.2021 ka miratuar shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues si dhe renditjen e kandidatëve që nuk kanë fituar mandat në bazë të votave parapëlqyese për zonën zgjedhore Qarku Tiranë. Rezulton se nga lista shumëmemërore e Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim për zonën zgjedhore Qarku Tiranë i plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 67, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 409 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në të cilin është miratuar renditja e kandidatëve të cilët nuk kanë fituar mandat, në bazë të numrit të votave parapëlqyese. Sipas këtij vendimi, rezulton se kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit është kandidati me numër rendor 16, zoti Petrit Doda. Nga ana e tij është depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formulari i vetëdeklarimit. Nga verifikimi i këtij formulari rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me ndalimet në Ligjin nr.138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka kërkuar

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ende nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore, ku rezulton se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Pas verifikimeve të kryera konstatohet se zoti Petrit Doda nuk përbën kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë. Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit Alfred Gjovalin Rrushaj i përket kandidatit vijues nga lista shumemërore e Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë i renditur me nr. 16, zoti Petrit Doda. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë, miratohet dhënia e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim për Qarkun Tiranë, zotit Petrit Dine Dodaj.

Vendimi nr. 211

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

01.12.2022
Ora, 11:19

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim, Qarku Tiranë, zonjës Orjela Nebijaj”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. E. Allushi.**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa)**
- **Të tjerë:** **Përfaqësues nga KRIIK, PAK**

Z. I. Celibashi: Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës që ka të bëjë me dhënien e mandatit të deputetit zonjës Orjela Nebijaj.

Z. Y. Merkaj: Kuvendi i Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvend nga dorëheqja e deputetes Grida Agim Duma, e cila është zgjedhur në zonën zgjedhore të Qarkut Tiranë, propozuar nga Koalicioni Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim. Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 409, datë 23.06.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në të cilin është miratuar renditja e kandidatëve të cilët nuk kanë fituar mandat, në bazë të numrit të votave parapëlqyese. Sipas këtij vendimi, rezulton se kandidati të cilit i kalon mandati i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

deputetit është kandidati me numër rendor 17, zonja Orjela Luftar Nebijaj, e cila ka plotësuar dhe depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, formularin e vetëdeklarimit me numër unik 53. Nga verifikimi i këtij formulari rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me ndalimet në Ligjin nr.138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, ende nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore për zonjën Orjela Nebijaj, ku rezulton se kandidatja nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë. Pas verifikimeve të kryera, referuar dhe pikës 2, të kreut V, të vendimit 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, të dhënat e kandidatit për deputet në zonën zgjedhore të Qarkut Tiranë, zonja Orjela Luftar Nebijaj, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë. Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetes zonjës Grida Duma, i përket kandidatit vijues nga lista shumëmemërore e Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim në zonën zgjedhore, Qarku Tiranë i renditur me nr. 17, zonjës Orjela Luftar Nebijaj. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Ndjesë dhe për pikën e parë, por përfaqësuesit e partive politike nuk kanë ndonjë gjë, besoj dakord! Mirë, miratohet dhënia e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatës së listës shumëmemërore të Koalicionit Partia Demokratike – Aleanca për Ndryshim për Qarkun Tiranë, zonjës Orjela Luftar Nebijaj.

Vendimi nr. 212

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

01.12.2022
Ora, 11:21

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Gramsh, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë së Gjelbër, zonjën Gerta Nuri Muça”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Stafii KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. E. Allushi.**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa)**
- **OJQ:** **Përfaqësues nga KRIIK, PAK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën e tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Gramsh.

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Gramsh, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltaria zoti Rigelda Lumshi, propozuar nga subjekti politik, Partia e Gjelbër. Kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë së Gjelbër, të cilës i kalon mandati i këshilltarit, është kandidatja me numër rendor 06, zonja Gerta Muça, e cila ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 48. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, konstatohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime të Ligjit nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*


gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë është dërguar verifikimi i të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ku rezulton se kandidatja ka ndryshuar mbiemrin pas martesë, ka marrë mbiemrin e bashkëshortit, nga Fejzo në Muça. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezulton se kandidatja është e padënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se kandidati për anëtar në Këshillin e Bashkisë Gramsh nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, atëhere vendos:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Gramsh, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë së Gjelbër, zonjën Gerta Nuri Muça.

Vendimi nr. 213

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

01.12.2022
Ora, 11:23

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Anxhela Ilirjan Bakiasi”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. E. Allushi.**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa)**
- **OJQ:** **Përfaqësues nga KRIIK, PAK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me projektvendimin “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë”.

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Tiranë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari Dorina Kuka, propozuar nga subjekti politik, Partia Socialiste. Kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste, të cilës i kalon mandati i këshilltarit, është kandidatja me numër rendor 69, zonja Anxhela Bakiasi, e cila ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 49. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, konstatohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime të Ligjit nr. 138/2015. Komisioni Qendror i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë është dërguar verifikimi i të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ku rezulton se kandidatia nuk ka ndryshime të përbërësve të gjendjes civile. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezulton se kandidatia është e padënuar me vendim penal të formës së prerë. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Mirë, atëhere vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Anxhela Ilirjan Bakiasi.

Vendimi nr. 214

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

01.12.2022
Ora, 11:24

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Skrapar, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Anila Zeni Ajdini”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. E. Allushi.**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa)**
- **OJQ:** **Përfaqësues nga KRIIK, PAK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, që ka të bëjë me projektvendimin “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Skrapar

Z. Y. Merkaj: Këshilli i Bashkisë Skrapar, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari Besnik Dembo, propozuar nga subjekti politik, Partia Socialiste. Kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të cilës i kalon mandati i këshilltarit, është kandidatja me numër rendor 20, zonja Anila Ajdini, e cila ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit, ku konstatohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime të Ligjit nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

gjqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë është dërguar verifikimi i të dhënave nga Drejtoria e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezulton se kandidatja është e padënuar me vendim penal të formës së prerë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Skrapar zonjës Anila Ajdini, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e saj në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Atëhere vendos:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Skrapar, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Anila Zeni Ajdini.

Vendimi nr. 215

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore. Në përgjigje të kërkesës sonë Drejtoria e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore ku rezulton se kandidatja është e padënuar me vendim penal të formës së prerë. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje. Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Devoll nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Atëhere, miratohet dhe plotësimi i vakancës në Këshillin e Bashkisë Devoll, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Megi Babi.

Vendimi nr. 216

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

01.12.2022
Ora, 11:26

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

PJESËMARRJA

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Stafi KQZ: **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,
Z. E. Meta, Znj. E. Allushi.**
- **Parti Politike:** **PD (I. Sefa)**
- **Të tjerë:** **Përfaqësues nga KRIIK, PAK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me projektvendimin “Për caktimin e masës së shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Z. Y. Merkaj: Neni 29 i Kodit Zgjedhor, parashikon se anëtarët e KZAZ-së nuk punojnë me kohë të plotë. KQZ-ja përcakton orarin e punës së KZAZ-së gjatë periudhës zgjedhore dhe jashtë saj. Për punën e kryer anëtarët përfitojnë shpërblim në masën e përcaktuar me vendim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Projektvendimi është parashikuar dhe ndarë në ndryshim nga zgjedhjet e kaluara. Ndarja është bërë në bazë të juridiksionit të qendrave të votimit që ka një KZAZ, ku është parashikuar se:

**Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU**

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

- KZAZ-të të cilat kanë në juridiksionin e tyre më pak se pesëdhjetë qendra votimi, kryetari dhe zv.kryetari do të paguhen në vlerën gjashtëdhjetë e pesë mijë lekë.
 - KZAZ-të të cilat kanë në juridiksionin e tyre deri në tetëdhjetë qendra votimi, kryetari dhe zv.kryetari, do të paguhen në vlerën njëqind mijë lekë.
 - KZAZ-të të cilat kanë në juridiksionin e tyre më shumë se tetëdhjetë qendra votimi, kryetari dhe zv.kryetari, do të paguhen në vlerën njëmijë e dyqind lekë, Gjithashtu dhe Sekretari i KZAZ-së, në përpjestim me punën e kryer nga kryetari dhe zv.kryetari që kanë në juridiksion këto qendra votimi është parashikuar:
 - Në masën gjashtëdhjetë mijë lekë, për KZAZ-të të cilat kanë në juridiksionin e tyre më pak se pesëdhjetë qendra votimi.
 - Në masën nëntëdhjetë e pesë mijë lekë, për KZAZ-të të cilat kanë deri në tetëdhjetë qendra votimi.
 - Në masën njëqind e tetëmbëdhjetë mijë lekë, për KZAZ-të të cilat kanë në juridiksionin e tyre më shumë se tetëdhjetë qendra votimi.
 - Anëtari i KZAZ-së shpërblehet në vlerën gjashtëdhjetë mijë lekë, nga momenti i konstituimit të saj deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.
 - Kryetari i Komisionit të Qendrës së Votimit shpërblehet në vlerën katër mijë lekë.
 - Anëtari dhe Sekretari i KQV-së shpërblehet në vlerën tre mijë e pesëqind lekë.
 - Anëtari i Grupit të Numërimit të Votave shpërblehet në vlerën gjashtë mijë lekë.
- Ky është propozimi i bërë nga administrata e KQZ-së për vendimmarrjen e Komisionerit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuesit e partive politike në lidhje me këtë projektakt? Përfaqësuesi i Partisë Demokratike!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Nuk isha i qartë në lidhje me vlerën se disa herë mu bë se ishin me të vjetra, nëdisa raste me të reja. Një mijë e dyqind lekë çfarë ishte? Mos është njëqind e njëzet mijë lekë?

Z. Y. Merhaj: Po njëqind e njëzet mijë lekë! Janë gjashtëdhjetë e pesë mijë, njëqind dhe njëqind e njëzet mijë lekë!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Dakord! Kryetari dhe Anëtari i KQV-së sa merr?

Z. Y. Merhaj: Katër mijë lekë kryetari, tre mijë e pesëqind lekë anëtari dhe sekretari.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Ne dakord jemi të jenë dyzet me thënë të drejtën, por puna është të mos bëjmë konfuzion se...

Z. I. Celibashi: Mirë, kemi ndonjë gjë tjetër? Jo!

Atëhere, pas këtij diskutimi lekë të reja, lekë të vjetra vendos të miratoj masën e shpërblimit për anëtarët e komisioneve zgjedhore si vijon:


Kryetari dhe zëvendëskryetari i Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, nga momenti i konstituimit deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve shpërblehet:

- Në vlerën gjashtëdhjetë e pesë mijë lekë, për KZAZ-të të cilat kanë në juridiksionin e tyre më pak se pesëdhjetë qendra votimi.

- Në vlerën njëqind mijë lekë, për KZAZ-të të cilat kanë në juridiksionin e tyre pesëdhjetë deri në tetëdhjetë qendra votimi.

- Në vlerën njëqind e njëzet mijë lekë, për KZAZ-të të cilat kanë në juridiksionin e tyre më shumë se tetëdhjetë qendra votimi.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

Sekretari i KZAZ-së, nga momenti i konstituimit deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve:

- Në masën gjashtëdhjetë mijë lekë, për KZAZ-të të cilat kanë në juridiksionin e tyre më pak se pesëdhjetë qendra votimi.

- Në vlerën nëntëdhjetë e pesë mijë lekë, për KZAZ-të të cilat kanë në juridiksionin e tyre pesëdhjetë deri në tetëdhjetë qendra votimi.

- Në vlerën njëqind e tetëmbëdhjetë mijë lekë, për KZAZ-të të cilat kanë në juridiksionin e tyre më shumë se tetëdhjetë qendra votimi.

Anëtari i KZAZ-së shpërblehet në vlerën gjashtëdhjetë mijë lekë, nga momenti i konstituimit të saj deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Kryetari i Komisionit të Qendrës së Votimit shpërblehet në vlerën katër mijë lekë.

Anëtari dhe Sekretari i KQV-së shpërblehet në vlerën tre mijë e pesëqind lekë.


Anëtari i Grupit të Numërimit të Votave shpërblehet në masën e gjashtë mijë lekë.

- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Vendimi nr. 217

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

01.12.2022
Ora, 11:33

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e programit për trajnimin dhe monitorimin e administratës zgjedhore dhe të disa aktorëve të tjerë për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore”.

PJESËMARRJA

- **KQZ**
 - 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z. Ilirjan Celibashi**
 - 2. Stafi KQZ:**
 - Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,**
 - Z. E. Meta, Znj. E. Allushi.**
- **Parti Politike: PD (I. Sefa)**
- **Të tjerë: Përfaqësues nga KRIIK, PAK**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës që ka të bëjë me miratimin e programit për trajnimin dhe monitorimin e administratës zgjedhore. Jemi gati?!

Z. E. Meta: Programi për trajnimin dhe monitorimin e administratës zgjedhore dhe disa aktorëve të tjerë për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore është hartuar për të mundësuar përmbushjen e parashikimit të nenit 19, të Kodit Zgjedhor. Programi për trajnimin dhe monitorimin e administratës zgjedhore përcakton metodologjinë e realizimit të trajnimit e cila konsiston në aplikimin e metodës kaskadë me dy shkallë. Fillimisht rekrutojmë disa trajnerë profesionistë të cilët do të trajnojnë kandidatët për trajnerë të administratës zgjedhore dhe këta të fundit do të trajnojnë me ekipe të


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

lëvizshme, administratën zgjedhore si dhe monitoruesit e fushatës zgjedhore, kandidatët e subjekteve politike, audituesit financiarë dhe financierët e partive politike si dhe administratën publike të pushtetit vendor. Programi i trajnimit përcakton kriteret e rekrutimit të kandidatëve për trajnerë. Sipas planifikimit dhe identifikimit të nevojave për trajnerë është vlerësuar se rekrutimi i tyre do të bëhet në dy faza: rekrutimi i trajnerëve afatgjatë të cilët do të trajnojnë administratën zgjedhore, monitoruesit audituesit e financierët e partive politike dhe trajnerët afatshkurtër të cilët do të angazhohen në periudhën që dinamika e trajnimeve rritet për shkak të krijimit të KQV-ve. Programi i trajnimit parashikon trajnimin e një numri më të madh sesa nevojat që KQZ ka për trajnerë pasi nga eksperiencat e mëparshme ka rezultuar që përgjatë periudhës së trajnimeve ka raste të tërheqjes së trajnerëve nga ky proces. Për këtë arsye është parashikuar se KQZ trajnon kandidatët për trajnerë në jo më pak se 5% se numri i nevojshëm që do të angazhohen në procesin zgjedhor, për të mbuluar nevojat që lindin nga krijimi i vakancave gjatë procesit. Programi i trajnimeve ka parashikuar mënyrën dhe kohëzgjatjen e trajnimit të kandidatëve për trajnerë, vlerësimin e tyre si dhe detyrat që trajnerët kanë përgjatë procesit të trajnimeve duke përfshirë edhe raportimin në kohë reale. Ky program ka parashikuar edhe aspektet financiare ku është trajtuar edhe vlerësimi i trajnimeve nga aspekti cilësor i tyre. Ky vlerësim bëhet nga KQZ përmes treguesve të performancës. Projektvendimi iu dërgua për mendim partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile, të cilat nuk kanë shprehur komente. Koalicioni për Reformë, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ka sugjeruar disa rekomandime në funksion të përmirësimit të tekstit të programit. KRIIK ka rekomanduar që në pikën 1 të programit, “Qëllimi dhe parimet”, të përcaktohen qartësisht aktorët e tjerë të ngarkuar me detyra zgjedhore. Ky rekomandim është marrë në konsideratë dhe është reflektuar në këtë pikë duke e riformuluar atë. KRIIK sugjeron që në këtë


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

Program, të parashikohen kategoritë që do të trajnohen, sfera e përgjegjësisve të tyre dhe ndërlidhja me aktet rregullatore përkatëse nëse ka, si dhe fushat e trajnimit, apo modulet kryesore. Veçanërisht kjo vlen për punonjësit e të administratës publike të pushtetit vendor apo kandidatët e subjekteve politike duke përcaktuar se për çfarë ata do të trajnohen. Ky rekomandim është marrë në konsideratë duke u reflektuar në Pjesën VII, pika 4, duke përcaktuar fushën e trajnimit të secilës kategori që do të përfshihen në procesin zgjedhor, përkatësisht, monitoruesit, kandidatët dhe administrata publike e organeve të qeverisjes vendore. KRIIK sugjeron se është e nevojshme të vendosen afate kohore kufi, si dhe elementë të tjerë kryesorë të nevojshëm, si psh. lidhur me monitorimin apo kostot financiare apo edhe se si do të organizohet kjo punë nga DSZMFM. Ky sugjerim është me vend, por mendojmë se këto detaje nuk mund të përfshihen në programin e trajnimit, pasi kalendari rakordohet në mënyrë dinamike me pushtetin vendor për administratën, me subjektet politike për kandidatët. Duke qenë se këto sugjerime janë të një natyre teknike, do të mbahen në konsideratë gjatë implementimit. Lidhur me modulet e trajnimit që do të përdoren, KRIIK sugjeron që në trajnime të trajtohen shkeljet e vërejtura nga procesi i auditit paszgjedhor për këqyrjen e materialeve zgjedhore qoftë të Zgjedhjeve Parlamentare 2021, qoftë të Zgjedhjeve të Pjesëshme Lokale 2022. Sugjerohet që ky parashikim të bëhet pjesë e tekstit të programit, si pikë më vete ose si plotësim i pikës IX.2. dhe IX.8. Reflektimi në pikat IX.2 dhe IX.8 nuk gjen vend pasi Kreu IX trajton aspektet financiare. Ndërkohë, e gjejmë me vend rekomandimin e KRIIK për trajtimin e sheljeve të vërejtura nga procesi i auditimit paszgjedhor dhe kjo do të përfshihet në modulën e trajnimit. KRIIK rekomandon që duhen marrë në konsideratë tërë gjetjet e analizës së bërë nga vetë administrata e KQZ-së, rastet e hetimit administrative gjatë proceseve operacionale të punës së KQZ-së. Për këtë rekomandim i dhënë nga KRIIK do të merret në konsideratë dhe mësimet e nxjerra

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

nga analiza paszgjedhore dhe vendimmarrja e KQZ-së do të përfshihen në modulën e trajnimit të monitoruesve, kandidatëve dhe administratës zgjedhore. Bashkëlidhur projektvendimi për miratim.

Z. I. Celibashi: Përfaqësuesit e partive politike, dakord, besoj? Kemi ndonjë shtesë? Edhe nga sa u relatua duket që në dokument janë reflektuar pothuajse të gjitha rekomandimet e bëra nga organizatat e shoqërisë civile, kryesisht nga KRIIK dhe disa elementë lidhen natyrshëm me implementimin konkret të këtij programi, ndaj mendoj që duhet ta miratojmë në qoftë se nuk kemi ndonjë gjë tjetër. Pra, miratojmë programin e trajnimit dhe me këtë rast komplimentojmë realisht ata anëtarë të stafit që kanë punuar mbi këtë dokument, pasi është një dokument shumë i mirë. Si rrallë më parë KQZ ka ndërtuar një program të trajnimit kohë përpara se të fillojë ky proces. Në çdo rast mbetet i rëndësishëm zbatimi i këtij programi. Mirë faleminderit, mbyllet dhe kjo pikë e rendit të ditës.

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Mundem?!

Z. I. Celibashi: Po!

Z. I. Sefa, përfaqësues i PD-së: Një propozim në lidhje me çështjen e trajnimit. Unë mendoj se është thelbësore. Partitë politike kanë tendencën që t'i ndryshojnë komisionerët ditën e fundit. Ndryshojnë dhe anëtarët e KZAZ-ve ditën e fundit dhe kjo krijon problematika për personat që nuk e njohin mënyrën e funksionimit. Mendoj që një pjesë e këtij trajnimi dhe informacioni të përgjithshëm të jetë dhe publik. Të jetë i shfaqur dhe në forma të tjera si në facebook, në televizione kombëtare. Pra, detyra juaj është ta përcillni sa më shumë si informacion, sa më

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

shumë të kenë njohuri njerëzit për mënyrën se si organizohet një ditë korrekte zgjedhjesh, aq më mirë është, sepse në qoftë se unë jam përfaqësues i Partisë Demokratike... në qoftë se ja lini në dorë partive politike, ato janë gjithmonë me tendencën për të fshehur komisionerë, për ti ndryshuar në momentin e fundit. Bëjnë trajnime vetë, unë në disa raste komisionerët e Partisë Demokratike i kam trajnuar vetë, por gjithësesi informacionet e përcjella nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë më shumë cilësore dhe më shumë efektive në një ditë zgjedhjesh organizuar në mënyrë të rregullt. Mendoj që duhet të gjeni dhe forma të tjera për transmetimin e këtij informacioni. Dakord trajnuesit është thelbësore dhe duhet, por duhen gjetur dhe forma të tjera nga KQZ-ja që të jenë prioritare në përcjelljen e këtij informacioni të domosdoshëm. Në fund të ditës zgjedhjet janë kulturë dhe realizimi i tyre tregon cilësinë dhe angazhimin e një shteti për të qenë brenda atyre standarteve që ne kërkojmë të jemi të gjithë.

Z. I. Celibashi: Ju falenderoj për ndërhyrjen dhe ndaj plotësisht me ju të njejtin mendim dhe opinion dhe besoj se do ta konsiderojmë këtë rekomandim pasi është vërtet me interes të dyanshëm. Për ne si administratë qendrore zgjedhore, përgjegjëse kryesore për administrimin e procesit zgjedhor, por mendoj dhe për partitë politike pasi dhe ato kanë interes që procesi zgjedhor nga pikëpamja teknike të zhvillohet në mënyrën më të mirë të mundshme. Kjo natyrshëm arrihet që ata që janë të angazhuar me administrimin e procesit zgjedhor të kenë njohuri të mjaftueshme. Kështu që ne do ta qasim edhe këtë formë sikurse ju propozuat, por ndërkohë mund të eksplorojmë dhe për mënyra të tjera. Ndoshta në rastin kur Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të zhvillojë trajnimin e komisionerëve, mund të marrin pjesë aty edhe të tjerë të cilët mund të mos jenë emëruar si anëtarë të KZAZ-së apo të KQV-së, apo dhe persona të tjerë të cilët partia politike mendon se

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.01.12.2022*

potencialisht në një moment të caktuar mund t'i caktojë. E mira do të ishte të ndryshonte kjo mënyrë organizimi dhe funksionimi të komisioneve të niveleve të dyta e të treta dhe Komisioni për Reformën Zgjedhore ta konsideronte atë propozim që KQZ i ka dërguar për këtë aspekt, por gjithësesi është çështje e tyre.

Mirë faleminderit! Kemi gjë tjetër?! Nuk kemi! Seanca mbyllet, ditë të mbarë!

Vendimi nr. 218

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

